

# SHPJEGIMI I TË TË DREJTAVE TUAJA

Nëse jeni **NDALUAR** me një urdhër arresti Evropian ose një Buletin për të Gjitha Pikat e Hyrjes (APB)

1/4

## Për çfarë të drejtash duhet t'ju informojnë përpara se të nisë intervista?

### 1. E drejta e një konsultimi konfidencial me një avokat dhe ndihma gjatë intervistës

#### A. Avokati

- Mund të kërkonti një avokat që e zgjidhni vetë.
- Nëse ju nuk keni një avokat, ose nëse ai ose ajo nuk mund të paraqitet, ju mund të kërkonti që të kontaktohet një avokat i gatshëm.
- Nëse ju plotësoni kushte të caktuara ligjore, kjo ndihmë ligjore është plotësisht ose pjesërisht falas. Ju mund të kërkonti formularin që përmban një përmbledhje të këtyre kushteve.

#### B. Konsultimi konfidencial paraprak

- Përpara intervistës tjetër - dhe brenda 2 orësh pasi të keni folur me avokatin në detyrë nga shoqata e avokataëve - ju keni të drejtën e një konsultimi konfidencial me avokatin tuaj për 30 minuta, që mund të zgjatet në raste të jashtëzakonshme me vendim të intervistuesit.
- Konsultimi mund të bëhet me anë të telefonit ose në vendin e intervistës
- Nëse konsultimi i planifikuar me avokatin tuaj nuk është bërë brenda kësaj periudhe 2-orëshe, keni prapë mundësi të kryeni një konsultim konfidencial me avokatin e gatshëm me anë të telefonit. Pas kësaj mund të nisë intervista.
- Nëse avokati juaj mbërrin gjatë intervistës, ai ose ajo mund të jetë i pranishëm gjatë pjesës së mbetur të procedimit.

#### C. Ndihma ligjore gjatë intervistës

- Ju keni të drejtën që të ndihmoheni nga avokati juaj gjatë intervistës që kryhet brenda 24 orësh nga arrestimi juaj.
- Avokati juaj do të sigurojë:
  - që të respektohet e drejta juaj për të heshtur dhe e drejta juaj për të mos e shpallur veten fajtor;
  - që të trajtoheni mirë gjatë intervistës dhe që të mos detyroheni ose të mos ushtrohet asnjë presion i jashtëligjshëm mbi ju;
  - që të informoheni për të drejtat tuaja dhe që intervista të kryhet në përputhje me ligjin.

Nëse avokati juaj ka ndonjë koment mbi këtë pikë, ai ose ajo mund t'i shënojë ato menjëherë në procesverbal.

Avokati juaj mund të kërkojë sqarime në lidhje me pyetjet që bëhen. Atij nuk i lejohet që t'i përgjigjet pyetjeve për ju ose ta pengojë intervistën.

- Ju ose avokati juaj keni të drejtë ta ndërprisni intervistën, vetëm një herë, për një konsultim konfidencial shtesë. Në të njëjtën mënyrë, nëse gjatë intervistës zbulohet ndonjë fakt i ri, ju mund të zhvillonit një konsultim konfidencial shtesë me avokatin tuaj. Ky konsultim nuk mund të zgjasë më tepër se 15 minuta.

# SHPJEGIMI I TË TË DREJTAVE TUAJA

Nëse jeni **NDALUAR** me një urdhër arresti Evropian ose një Buletin për të Gjitha Pikat e Hyrjes (APB)

2/4

## D. Heqja dorë

Ju nuk jeni i detyruar të kërkontë konsultim me ose ndihmë nga një avokat.

Ju mund të hiqni dorë nga kjo e drejtë vullnetarisht dhe pasi e keni menduar seriozisht:

- nëse jeni në moshë madhore;
- kur të keni nënshkruar një dokument ku është shënuar dhe data, ku thuhet se ju hiqni dorë nga kjo e drejtë.
- nëse është e mundur intervista do të filmohet. Ju mund ta diskutoni këtë me avokatin tuaj (shih edhe pjesën 7).

Për këto çështje, mund të flisni në telefon me një nga avokatët në detyrë të Shoqatës së Avokatëve.

## E. Përrjashtimi

Në rastin e rrethanave të veçanta ose për arsye bindëse, Drejtori i Prokurorisë ose gjykatësi mund të vendosin që të mos jua japin të drejtën e konsultimit konfidencial paraprak ose të ndihmës nga një avokat gjatë intervistës. Ai ose ajo duhet ta justifikojë këtë vendim.

## F. E drejta e një avokati në shtetin ku është lëshuar urdhër-arresti evropian

Ju keni të drejtën të caktoni një avokat në shtetin ku është lëshuar urdhër-arresti evropian. Ky avokat mund t'i japë avokatit tuaj në Belgjikë informacion dhe këshilla për procedurën e ekstradimit.

## 2. Informacioni në lidhje me urdhër-arrestin evropian ose APB-në

- Ju keni të drejtën të informoheni mbi përmbajtjen e urdhër-arrestit evropian ose APB-së.
- Nëse është aplikuar që ju të ekstradoheni me mendimin që të vendosej një gjobitje dhe ju nuk e dinit këtë dënim ose procedimet penal në vijim, mund të kërkontë që t'ju jepet një kopje e dënimit të

huaj, që ta lexoni dhe nëse kjo gjë mund të bëhet në kohë.

## 3. E drejta për të heshtur

- Në asnjë pikë nuk do të jeni i detyruar të shpallni veten fajtor.
- Pasi të deklaroni identitetin tuaj, ju mund të zgjidhni të bëni një deklaratë, t'i përgjigjeni pyetjeve që ju bëhen ose të

heshtni.

## 4. E drejta për të njoftuar dikë se jeni arrestuar

Ju keni të drejtën që të njoftoni një palë të tretë për arrestimin tuaj.

Megjithatë, Drejtori i Prokurorisë ose gjykatësi mund ta shtyjnë fazën në të cilën ky veprim mund të kryhet, për aq kohë sa të jetë e nevojshme për të ruajtur integritetin e hetimit.

## 5. Asistenca mjekësore

- Ju keni të drejtën e asistencës mjekësore falas, nëse e keni të nevojshme.
- Ju gjithashtu mund të kërkontë që ta zgjidhni vetë doktorin që do t'ju ekzaminojë. Ky ekzaminim bëhet me shpenzimet tuaja.

## Cilat janë të drejtat tuaja shtesë gjatë intervistës?

### 6. Të drejta të tjera gjatë intervistës

Përpara intervistës juve do ju jepen disa informacione. Përveç një informacioni të shkurtër rreth fakteve dhe të drejtës për të heshtur, ju do t'ju thuhet se:

- Ju mund të kërkonti që të gjitha pyetjet që bëhen dhe përgjigjet që ju jepni për këto pyetje të regjistrohen ashtu siç jepen;
- Mund të kërkonti që të bëhet një hetim i caktuar ose që të intervistohet një person i caktuar;
- Deklaratat tuaja mund të përdoren në gjykatë si prova.
- Gjatë intervistës, ju mund të përdorni të gjitha dokumentet që keni në pronësi, për sa kohë që, me qëllim që të veproni kështu, intervista nuk shtyhet.

Gjatë ose pas intervistës ju mund të kërkonti që këto dokumente t'i bashkëngjiten proces-verbalit me shkrim ose të depozitohen te kancelari i gjykatës.

### 7. Fillimi i intervistës

- Nëse është e mundur intervista do të filmohet për të monitoruar procedimin e intervistës.
- Kjo gjë vendoset nga intervistuese, Prokurori Publik ose Gjykatësi.

### 8. Në përfundim të intervistës

Në përfundim të intervistës, do t'ju jepet teksti i intervistës në mënyrë që ta lexoni.

Ju gjithashtu mund të kërkonti që këtë t'ju lexojë dikush tjetër. Ju do t'ju kërkohet nëse do të donit të bënit ndonjë ndryshim ose sqarim në deklaratat tuaja.

### 9. Asistenca e përkthyesit

- Nëse keni nevojë të flisni në një gjuhë të ndryshme nga ajo e procedimit, policia do të thërrasë një përkthyes të vënë nën betim që t'ju ndihmojë gjatë intervistës. Kjo ndihmë është falas.
- Nëse keni nevojë të flisni në një gjuhë të ndryshme nga ajo e procedimit, policia do të thërrasë një përkthyes të vënë nën betim që t'ju ndihmojë gjatë intervistës. Kjo ndihmë është falas.
- Ju gjithashtu mund të ftoheni që të regjistroni edhe vetë deklaratat tuaja në gjuhën tuaj.

### 10. Dhënia e pëlqimit për ekstradimin

Mund të bini dakord që të ekstradoheni në vendin ku dëshironi ju. Ju mund ta kufizoni dhënien tuaj të pëlqimit vetëm për shkeljet e specifikuar në urdhër-arrestin evropian. Mund edhe që të hiqni dorë nga rregulli i specialitetit, që do të thotë se pasi të jeni ekstraduar do të ndiqeni penalisht ose do të burgoseni si pjesë e zbatimit të një dënimit të dhënë për shkeljet përveç atyre për të cilat është aplikuar për ekstradimin.

Nëse doni të bini dakord me ekstradimin, pas intervistës nga Gjykatësi, do të dëgjoheni nga Prokurori Publik. Prokurori Publik do t'ju shpjegojë ndërlikimet. Mund të ndihmoheni nga avokati juaj. Mund të jepni pëlqimin për ekstradimin tuaj vetëm përpara Prokurorit Publik.

Pasi të keni dhënë pëlqimin ligjërish që të ekstradoheni, nuk mund ta ndryshoni më vendimin tuaj.

## Për sa kohë mund të mbaheni i ndaluar?

### 1. Në parim 48 orë

Ju mund të mbaheni i ndaluar për një periudhë maksimale prej 48 orësh.

### 2. Gjykatësi

- Brenda hapësirës kohore të 48 orëve, ju ose do të liroheni ose do të dërgoheni në paraburgim nga gjykatësi. Ky i fundit ka fuqinë të vendosë për ndalimin tuaj dhe për lëshimin e një urdhër arresti evropian.
- Gjykatësi është i detyruar që t'ju pyesë juve më parë për këtë çështje. Keni të drejtën të ndihmoheni nga avokati juaj. Gjykatësi duhet të dëgjojë komentet tuaja, ose të avokatit tuaj, në lidhje me mundësinë e lëshimit të një urdhër arresti.

Ju nuk mund të hiqni dorë nga kjo e drejtë nëse jeni në moshë madhore.

- Nëse gjykatësi lëshon një urdhër arresti, ju do të keni të drejtat e mëposhtme:
  - Ju mund të komunikoni lirshëm me avokatin tuaj.
  - Brenda pesëmbëdhjetë ditësh pasi të jeni arrestuar do të paraqiteni përpara Gjykatës, ku mund ta kundërshtoni ndalimin dhe ekstradimin tuaj nën një urdhër-arrestit evropian. Ju mund ta apeloni këtë vendim përpara Gjykatës së Padive, që do ta japë vendimin brenda pesëmbëdhjetë ditësh. Apeli duhet të dorëzohet brenda njëzetekatër orësh pasi t'ju jetë dhënë vendimi i Gjykatës.

- Ju mund të shqyrtoni dosjen tuaj një ditë përpara seancës dëgjimore me dyer të mbyllura.
- Avokati juaj mund t'ju japë informacione shtesë për vijimin e mëtejshëm të këtyre procedimeve.
- Nëse nuk keni shtetësi belge, ju keni të drejtë të informoni autoritetet tuaja konsullore për arrestimin tuaj.
- Nëse nuk e kuptoni gjuhën e urdhër-arrestit evropian, ose gjuhën të të cilën është përkthyer, do t'ju jepet një përkthim me shkrim i urdhër-arrestit evropian në një gjuhë që ju e kuptoni, ose një përkthim me gojë i urdhër arrestit evropian ose një përkthim me gojë i raporteve procedurale thelbësore përpara se të paraqiteni përpara Gjykatës dhe më së fundi, përpara se një urdhër përfundimtar të jetë kthyer në lidhje me zbatimin.

**Këtë deklaratë të të drejtave tuaja mund ta mbani.**